



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 413/01-15758
Dt: 09.08.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe dispozitat të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 7 të Kontratës me numër 01-413/01-21522, me datë 09.08.2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Shkëputet Kontrata për Dhënien në Shfrytëzim afatshkurtër të Pronës Komunale me numër 01-413/01-21522 e datës 19.09.2022, e lidhur ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe Kompanisë për furnizim dhe Distribuim të Energjisë Elektrike "KEDS" SH.A me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson Kryeshef Ekzekutiv i KEDS-it, z. Alpin Dogan.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, obligohet Drejtoria për Punë Inspektuese që të largoj nga prona komunale, personat e paautorizuar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës dhe Kompania për furnizim dhe Distribuim të Energjisë Elektrike "KEDS" SH.A, kanë lidhur Kontratë me numër 01-413/01-21522 e datës 19.09.2022, për Dhënien në Shfrytëzim afatshkurtër të Pronës Komunale - pjesë e parcelës me nr.P-70705053-00209-0 Z.K. Orize (pronë shoqërore-rrugë publike) - lokacioni në rrugën "Martirët Sokoli" në sipërfaqe prej 34.0m².

Shfrytëzuesi përmes kërkesës me numër 01-413/01-14618 të datës 21.07.2023, ka kërkuar që me mirëkuptim të shkëputet kontrata me numër 01-413/01-21522 e datës 19.09.2022, për shkak se ka reviduar projektin LP 10 (20) kv Dobroshti, me revidimin e projektit është ndryshuar traseja e një segmenti të largpërçuesve, si dhe është ndryshuar lokacioni i vendosjes së stabilimentit të ri shpërndarës.

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, në nenin 7 të Kontratës për Dhënien në Shfrytëzim afatshkurtër të Pronës Komunale, si dhe kërkesës së shfrytëzuesit, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën kompetente, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të të njëjtit.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Kuvendit të Komunës
- Drejtorisë për Punë Inspektuese
- Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë
- Palës
- Arkivit.

Ardian Gjini



Kryetar i Komunës së Gjakovës

